

Vendim nr. 276 datë 15.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Illir Toska, Anëtar

në datën 15.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (L) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: LAERT KOLA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-3109, datë 12.06.2024 të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimi i procedurave dhe shpërblimi i dëmit për çështjen gjyqësore administrative nr. 31001-00190-00-2023, datë 11.04.2023.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, 13, 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin nr. 132, datë 14.02.1996 të Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve Fier (*vendimi nr. 132/1996 i KKKP, Fier*) është vendosur, ndër të tjera, njohja e pronësisë së shtetasit J.K. për një truall me sipërfaqe 5000 m², të ndodhur në fshatin Grecalli, Komuna Qendër, Fier dhe kompensimi me truall fizik i trashëgimtarëve të tij ligjorë. Vendimi është regjistruar në regjistrat e kohës të zyrës së hipotekës Fier (regjistrat hipotekarë), ndërsa në datën 01.04.2015 kërkuesi Laert Kola (trashëgimtar i të ndjerit J.K.) ka kërkuar (ri)regjistrimin e aktit të fitimit të pronësisë në regjistrat e pasurive të paluajtshme, kërkesë e cila është refuzuar me arsyetimin se vendimi nr. 132/1996 i KKKP-së, Fier nuk mund të regjistrohej në regjistrat e pasurive të paluajtshme, pasi pasuria ishte regjistruar më parë në emër të Komunës Qendër, Fier sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 06.07.2011 (*VKM nr. 509/2011*).

2. Në datën 11.12.2015 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me kërkesëpadi, duke paditur Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (*ASHK*), Drejtorinë Vendore Fier, si dhe duke thirrur si person të tretë Bashkinë Fier. Ai ka kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, regjistrimin e pasurisë nr. 128/1, ZK nr.1453, terren sportiv, të regjistruar sipas VKM-së nr. 509/2011 në emër të Komunës Qendër, Fier; detyrimin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Fier (*ZVRPP, Fier*) të fshijë nga regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme subjektin Komuna Qendër, Fier për pasurinë e pretenduar prej tij dhe të regjistrojë pronarët sipas vendimit nr. 132/1996 të KKKP-së, Fier; të shfuqizojë aktin administrativ të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme në emër të subjektit Komuna Qendër, Fier dhe sigurimin e padisë.

3. Në përfundim të gjykimit të çështjes, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 447, datë 31.03.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Kërkuesi ka paraqitur ankim ndaj këtij vendimi në Gjykatën Administrative të Apelit. Në kushtet kur kjo e fundit nuk e kishte shqyrtuar çështjen ende, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë sipas neneve 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*) për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës së gjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, si dhe shpërblimin e dëmit. Me vendimin nr. 25/22, datë 17.06.2021, Kolegji Administrativ

i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuarit dhe pushimin e gjykimit në lidhje me kërkimin për shpërblimin e dëmit.

4. Në datën 12.10.2021 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e vendimit nr. 25/22, datë 17.06.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që ka rrëzuar kërkesën e tij për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshem dhe përshpejtimin e procedurës së gjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit. Me vendimin nr. 3, datë 17.02.2022 (*vendimi nr. 3/2022*), Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuarit, shfuqizimin e vendimit në fjalë të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshem dhe urdhërimin e Gjykatës Administrative të Apelit për të gjykuar çështjen brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Në zbatim të vendimit të Gjykatës, Gjykata Administrative e Apelit e ka gjykuar çështjen dhe, në përfundim, me vendimin nr. 591, datë 07.12.2022, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 447, datë 31.03.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe pranimin e kërkesëpadsisë, duke shfuqizuar urdhrin nr. 664, datë 01.12.2015 të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (*ZQRPP*) dhe urdhëruar të paditurin, ASHK-në, Drejtorinë Vendore Fier: i) të fshijë regjistrimin e pasurisë nr. 128/1, ZK nr. 1453, terren sportiv, në emër të Komunës Qendër, Fier sipas VKM-së nr. 509/2011; ii) të regjistrojë këtë pasuri në përputhje me vendimin nr. 132/1996 të KKKP-së, Fier. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs ASHK-ja, Drejtoria Vendore Fier, Avokatura e Shtetit dhe Bashkia Fier (*palët e paditura në gjykim*), si dhe kundërrkurs kërkuari. Çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 11.04.2023 me nr. 31001-00190-00-2023.

6. Paralelisht me këtë proces gjyqësor kërkuari ka nisur procedurën për ekzekutimin e vendimit nr. 591, datë 07.12.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit. Në kushtet kur debitori nuk po ekzekutonte titullin ekzekutiv, në datën 18.05.2023 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me kërkesë, me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshem dhe përshpejtimin e procedurës së ekzekutimit të atij vendimi. Ajo gjykatë, me vendimin nr. 101, datë 20.06.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuarit.

7. Në datën 13.10.2023 kërkuari i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për shfuqizimin e vendimit nr. 101, datë 20.06.2023 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe konstatimin e cenimit të së drejtës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr. 591, datë 07.12.2022

të Gjykatës Administrative të Apelit brenda një afati të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të ekzekutimit të vendimit për regjistrimin e pronës. Me vendimin nr. 39, datë 14.05.2024 (*vendimi nr. 39/2024*), Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës, shfuqizimin e atij vendimi, konstatimin e cenimit të së drejtës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe urdhërimin e ASHK-së të përfundojë ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

8. Po kështu, në vijim të vendimit nr. 3/2022 të Gjykatës, kërkuesi i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë me kërkesëpadi, me objekt shpërblimin e dëmit si rezultat i konstatimit të cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm në Gjykatën Administrative të Apelit. Në lidhje me këtë padi, me vendimin nr. 4211, datë 05.08.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin pjesërisht të saj, vendim ndaj të cilit pala e paditur ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Në kushtet kur kjo e fundit nuk ka shqyrtuar ankimin, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës duke kërkuar në thelb mungesën e efektivitetit të mjetit kompensues. Gjykata, me vendimin nr. 45, datë 11.06.2024, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe konstatimin e shkeljes së të drejtës për proces të rregullt për shkak të mungesës së efektivitetit të mjetit kompensues.

9. Ndërkohë, në çështjen e themelit të regjistruar në Gjykatën e Lartë për rekursin e paraqitur nga palët e paditura në gjykim, kërkuesi i është drejtuar asaj gjykate me tri kërkesa për përshpejtimin e gjykimit (në datat 19.01.2024, 16.02.2024 dhe 20.03.2024). Në vijim, në datën 29.03.2024 ai i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e gjykimit të çështjes nga ajo gjykatë dhe shpërblimin e dëmit bazuar në nenet 399/1 e vijues të KPC-së.

10. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3109, datë 12.06.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës me arsyetimin se referuar nenit 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së, afati i arsyeshëm për përfundimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë do të konsiderohet afati 2-vjeçar nga dita e paraqitjes së kërkesës, ndërkohë që në rastin konkret regjistrimi i rekursit në Gjykatën e Lartë është bërë në datën 11.04.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë gjykatë në datën 05.04.2024. Po kështu, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se mosveprimi nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit, por me ngarkesën totale të gjyqtarit relator, i cili ka marrë të gjitha masat e nevojshme, duke përcaktuar edhe kritere transparente për shqyrtimin e çështjeve, sipas radhës së vjetërsisë së tyre.

11. Me kërkesën e datës 15.08.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuessit

12. *Kërkuessi*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

- 12.1. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi nga momenti i depozitimit të padisë kanë kaluar 9 vjet, duke tejkaluar të gjitha afatet tërësore të gjykimit. Gjykata e Lartë në datën 03.07.2023 e ka kaluar çështjen në seancë gjyqësore në dhomën e këshillimit, duke bërë një vlerësim paraprak të shkaqeve të rekursit të palës së paditur në gjykim. Gjykimi me kolegje seleksionuese në çështjet administrative është diskriminues dhe në kundërshtim me ligjin, pasi i jep të drejtë gjykatës që disa çështje të përfundojnë së gjykuari dhe disa të mbeten në pritje. Gjykata e Lartë nuk i është përgjigjur kërkesës për informacion në lidhje me momentin e përfundimit të gjykimit. Vendimi i gjykatës së apelit, i cili është i formës së prerë dhe në favor të kërkuessit, nuk është ekzekutuar nga ASHK-ja, ndonëse për këtë fakt është shprehur Gjykata me vendimin nr. 39/2024. Çështja nuk paraqitet komplekse, sjellja e kërkuessit nuk rezulton të ketë përbërë shkak për zvarritjen e gjykimit, ndërsa autoritetet shtetërore të paditura në gjykim refuzojnë të zbatojnë një vendim të formës së prerë.
- 12.2. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi argumenti i Gjykatës së Lartë se nuk është plotësuar afati 2-vjeçar i parashikuar nga neni 399/2, pika 1, shkronja “b”, i KPC-së për paraqitjen e kërkesës për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm, është i gabuar. Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh faktin se procesi gjyqësor në shkallën e parë i ka tejkaluar afatet dhe nga dorëzimi i ankimit në gjykatën e apelit kanë kaluar 5 muaj. Afati i parashikuar në atë dispozitë i referohet procesit civil dhe palëve u lind e drejta të paraqesin kërkesë për konstatimin e tejzgjatjes së gjykimit në bazë të disa veçorive të rastit.
- 12.3. *Së drejtës së pronës*, pasi megjithëse kërkuessi ndodhet në kushtet e një vendimi të formës së prerë, i cili i ka njohur titullin e pronësisë, organet shtetërore refuzojnë ekzekutimin e tij, duke e privuar nga gëzimi i pronës për një periudhë 13-vjeçare.
- 12.4. *Parimit të barazisë përpara ligjit të lidhur me parimin e sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë në çështje të ngjashme ka vendosur pushimin e gjykimit për konstatimin e

shkeljes së afatit të arsyeshëm, pasi gjyqtari relator ka ndërmarrë veprime për planifikimin e gjykimit të çështjes, ndonëse nuk janë përmbushur afatet e arsyeshme të gjykimit. Në këto raste, Gjykata e Lartë e ka gjykuar rekursin me procedurë të përshpejtuar.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuessit

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

14. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të.

15. Kolegji vëren se kërkuessi në objektin e ankimit kushtetues individual ka kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-3109, datë 12.06.2024 të Gjykatës së Lartë, me të cilin është vendosur rrëzimi i kërkesës për konstatimin e afatit të arsyeshëm të gjykimit të rekursit të palëve të paditura në një proces gjyqësor administrativ të vënë në lëvizje prej tij. Kërkuessi ka pretenduar se ndonëse vendimi i gjykatës së apelit është i formës së prerë dhe titull ekzekutiv, ai ende nuk është ekzekutuar nga organet shtetërore, të cilat kanë ushtruar rekurs. Nga aktet bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, Kolegji konstaton se Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrimin se shqyrtimi i çështjeve bëhet në bazë të një radhe gjykimi, në përputhje me periudhën e regjistrimit.

16. Nga sa më sipër, ndonëse kërkuesi ka pretenduar konstatimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm të rekursit të palës së paditur në gjykim, për sa kohë që është palë në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë, ai legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

17. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi ka paraqitur më parë kërkesë në Gjykatën e Lartë, në zbatim të neneve 399/1 e vijues të KPC-së, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e shqyrtimit të çështjes së tij të regjistruar në atë gjykatë, për të cilën Kolegji Civil, me vendimin nr. 00-2024-3109, datë 12.06.2024, ka vendosur rrëzimin e saj. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion të kërkuesit për rivendosjen e së drejtës së pretenduar të cenuar është ankimi kushtetues individual.

18. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi jo vetëm që shkelja është vazhduese, por vendimi i Gjykatës së Lartë për kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm është i datës 12.06.2024, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 15.08.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

19. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Kolegji evidenton se pretendimet për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit të Gjykatës së Lartë, së drejtës së pronës dhe parimit të barazisë përpara ligjit të lidhur me parimin e sigurisë juridike janë në funksion të pretendimit kryesor për tejzgjatjen e gjykimit të rekursit në këtë gjykatë.

20. Në analizë të çështjes së kërkuesit, Kolegji vëren se thelbi i mosmarrëveshjes është me natyrë administrative, prandaj, referuar nenit 60 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, Gjykata e Lartë e shqyrtton çështjen brenda 90 ditëve nga data e ardhjes së rekursit dhe akteve bashkëlidhur prej gjykatës ku është depozituar rekursi. Ndërsa KPC-ja, me ndryshimet e vitit 2017, ndonëse nuk shprehet specifikisht për gjykimin administrativ në Gjykatën e Lartë, ka përcaktuar afatin 2-vjeçar për përfundimin e gjykimit civil në Gjykatën e Lartë (neni 399/2, pika 1, shkronja “b”). Në pikën 2 të këtij neni parashikohet se palët në proces mund të kërkojnë konstatimin e tejzgjatjes së procedurave, sipas nenit 399/6, pika 1, edhe pa kaluar afatet e mësipërme, duke pasur parasysh

kompleksitetin e çështjes, objektin e mosmarrëveshjes, të procedimit ose të gjykimit, sjelljen e organit që po kryen procedurat, si dhe të çdo personi tjetër të lidhur me çështjen, kur pretendojnë zvarritje të hetimit, gjykimit ose ekzekutimit të vendimit.

21. Kolegji vëren se ankimi kushtetues individual është paraqitur në vijim të tre vendimeve të Gjykatës, në të cilat kërkuessit i është konstatuar cenimi i së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm (në gjykatën e apelit) dhe ekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm (të vendimit të formës së prerë), si dhe mungesa e efektivitetit të mjetit kompensues. Duke mbajtur në konsideratë thelbin e mosmarrëveshjes, Kolegji evidenton se kërkuessi ka kërkuar regjistrimin e pasurisë së njohur trashëgimlënësit të tij me vendimin e ish-KKKP-së, për të cilin Gjykata më parë, ndërsa ka konstatuar cenimin e së drejtës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, ka urdhëruar detyrimin e institucioneve përkatëse për zbatimin e tij (vendimi nr. 39/2024), pra regjistrimin e pasurisë së kërkuessit. E thënë kjo, shqyrtimi i rekursit të palëve të paditura në gjykim nuk ndikon në të drejtën e tij për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, gjë për të cilën kërkuessi ka marrë përgjigje më parë edhe nga Gjykata. Për më tepër, sikurse rezulton nga rrethanat konkrete, rekursi është regjistruar në datën 11.04.2023, çka do të thotë se ende nuk është përmbushur afati 2-vjeçar, i cili konsiderohet afat i arsyeshëm i gjykimit të rekursit në Gjykatën e Lartë.

22. Për sa më sipër, Kolegji vë në dukje se në situatën aktuale të kërkuessit nuk ka ndonjë rrethanë me natyrë kushtetuese që të mund të vendosë në lëvizje gjykimin kushtetues, në kushtet kur çështja në thelb lidhet me (mos)veprimin e organeve shtetërore, për të cilat ai ka mjete në dispozicion për të kërkuar ushtrimin e detyrës prej tyre dhe realizimin e së drejtës së tij të njohur edhe nga gjykimet e mëparshme kushtetuese. Nën këtë analizë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuessit që lidhet me të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, në aspektin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm të rekursit në Gjykatën e Lartë, nuk mund të merret në shqyrtim dhe ankimi i ri kushtetues i tij nuk plotëson kriteret për shqyrtim në seancë plenare.

23. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.